REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 665/22
Datë/Datum. 10.01.2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
RepublikaKosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

OrganiShqyrtuesiProkurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 665/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: Vedat Poterqoi- Kryetar, Kimete Gashi- Anëtare, Agon Ramadani- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik"Fitim R. Bilalli B.I - DardaniX"- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit:"Furnizim me Aparata të Frymëmarrjes dhe Bombola të Ajrit" me nr. të prokurimit 21432700-22-3555-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) — Agjencia për Menaxhim Emergjent,me datën 10.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. **Refuzohet,** si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik "Fitim R. Bilalli B.I - DardaniX"- Prishtinë, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 16. 11. 2022 me numër protokolli 665/2022 për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Aparata të Frymëmarrjes dhe Bombola të Ajrit" me nr. të prokurimit 21432700-22-3555-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Agjencia për Menaxhim Emergjent.

2. **Mbetet në fuqi,** njoftimi për dhënie të kontratës "Furnizim me Aparata të Frymëmarrjes dhe Bombola të Ajrit" me nr. të prokurimit 21432700-22-3555-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) — Agjencia për Menaxhim Emergjent.

3. Meqenëse ankesa e operatorit ekonomik ankues "Fitim R. Bilalli B.I - DardaniX"- Prishtinë refuzohet si e pabazuar, të njëjtit i konfiskohet tarifa e paguar me rastin e parashtrimit të ankesës

në kuptim të nenit 31 paragrafi 5 i LPP-së dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datën: 16.11.2022, OE "Fitim R. Bilalli B.I - DardaniX"- Prishtinë, ka ripërsëritur ankesën në OSHP kundër njoftimit për anulim të aktivitetit te prokurimit: "Furnizim me Aparate të Frymëmarrjes dhe Bombola të Ajrit" me nr. të prokurimit 21432700-22-3555-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia për Menaxhim Emergjent.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

OSHP ka angazhuar ekspertin e jashtëm shqyrtues të prokurimit që në pajtim nenin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore i cili në raportin e datës 05. 12.2022 ka rekomanduar që:

- tëaprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE ankues, si dhe
- Kjo çështje sipas ekspertit është çështje e gjykuar

Përgjigje ne pretendimet e përsëritura ankimore:
Pas shqyrtimit të ankesës kundrejt pretendimeve te përsëritura ankimore të "Fitim R. Bilalli B.I" janë te njëjtat mbi te cilat Organi Shqyrtues ka dhënë përgjigje me date 03.11.2022 me nr. PSH.nr.408/22:

- Sipas Raportit të Vlerësimit të tenderëve nga ana e Komisionit nuk ka qenë i pajtueshëm apo përgjegjshëm, për arsye ne katalogun e dorëzuar te prodhuesit i cili nuk i plotëson specifikimin teknik ne pikat:
- 1. Maska nuk posedon dy shtresa izolimi
- 2. Maska nuk posedon konektimin e kërkuar "P" por posedon tjetër lloj konektimi M16.

Sa i përket pretendimit nr.1 se Maska nuk posedon dy shtresa izolimi, kjo lehte vërehet dhe vërtetohet ne katalogun e vulosur dhe nënshkruar nga përfaqësuesi ku deklarojnë qe maska përbehet prej dy shtresave. Citojmë ne Anglisht: THE MASS OF MASK CONSIST OF TËO LAYERS OF DOUBLE INSULATION TO ENSURE A SECURE AND SAFE FIT FOR ALL FACIAL FORMS. Andaj ky pretendim është sqaruar
edhe ne raportin e pare te ekspertit si dhe ne Vendimin e OSHP-se nr. 408/22 si i pabazuar.

MASK - Full Face Mask – S Mask	
The mass of mask consists of two layers of double insulation to ensure a secure and safe fit for all facial forms	
The mask has the design of the headband to ensure quick, easy placement, provide safe and comfortable isolation and comfortable fit of all facial forms	
The material of the mask is: • natural rubber	
Sizes	3 sizes
The face mask is equipped with an integrated breathing valve, locked in the face mask The breathing valve does not come loose during operation. The face mask is equipped with an ambient air clip that enables the use of ambient air while in stand-by.	
Positive pressure activates • manually (with a one-hand push on the exhalation valve cover), or • automatically	
The breathing valve is in the center or on any side of the mask, and it doesn't block the field of view. Tested in accordance with 89/686EEC standards EN 136:1998	
The connection system with breathing apparatus	P
Mask weight	550-800 gr
Approvals	EN 136 or EN 137:2006

Kristoffer Nilsson

Sales Manager Interspiro

INTERSPIRO

-Konsiderojë që Autoriteti Kontraktues nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret mbi konkurrueshmërinë te vendosura në dosjen e tenderit, konform rregullave dhe Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092,

-Neni 28 për Specifikimet teknike te tenderit, si dhe Neni 56 pika 2.2 mbi Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave:

-Neni 28 mbi Specifikimet teknike pika:

- 2. Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është

veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik. Dhe

6. Nëse një tenderues mund të paraqet në tenderin e tij, përmes çfarëdo mase të duhur (siç janë, dosjet teknike ose raport testimi nga një palë e tretë e pavarur), se zgjidhja e propozuar nga tenderuesi në mënyrë ekuivalente plotëson kërkesat e definuara në specifikim teknik, autoriteti kontraktues nuk mund të refuzoj tenderin me arsyetimin se produkti ose shërbimi i ofruar nuk përputhet me specifikimet teknike të formuluara duke iu referuar ndonjë specifikimi të përmendur në paragrafin 4. dhe 5. të këtij neni.

7. Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij neni ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët "ose ekuivalent"

Maska e fytyrës duhet të jetë e pajisur me një valvul të integruar të frymëmarrjes, të kyçur në maskën e fytyrës Valvula e frymëmarrjes nuk duhet të jetë e mundur të humbasë gjatë operacionit Maska e fytyrës duhet të jetë e pajisur me një kapëse të ajrit të ambientit që mundëson përdorimin e ajrit të ambientit ndërsa është në pritje.	
Presioni pozitiv duhet të aktivizohet • Manualishti (me një shtytje të njërës anë mbi kapakun e valvulës së nxjerrjes) • Automatikisht	
Valvula e frymëmarrjes duhet të jetë në qendër ose në njërën anë të maskës dhe nuk duhet të bllokojë shikimin. Testuar në përputhje me standardet 89 / 686EEC, EN 136: 1998	
Sistemi i lidhjes me aparatet e frymëmarrjes	P
Pesha e maskës	550-800 gr
Aprovimet	EN 137 ose EN 137:2006

Tek Dosja e tenderit ne fushën ku kërkohet sistemi i lidhjes me aparatet e frymëmarrjes vërehet qe është specifikuar lloji "P" si shenje dalluese, andaj konsideroje qe me këtë rast është ngushtuar konkurrenca dhe janë shkelur dispozitat e LLP-se Nenit 28 dhe pikat e lartë cekura, posaçërisht pika 6 e Nenit 28 ku thotë: Se nëse zgjidhja e propozuar nga tenderuesi në mënyrë ekuivalente plotëson kërkesat e definuara në specifikim teknik, autoriteti kontraktues nuk mund të refuzoj tenderin me arsyetimin se produkti ose shërbimi i ofruar nuk përputhet me specifikimet teknike të formuluara duke iu referuar ndonjë specifikimi të përmendur në paragrafin 4. dhe 5. të këtij neni.

Duke marre edhe për baze kërkesën për sqarim nga Operatori Ekonomik i propozuar për kontratë drejtuar Autoritetit Kontraktues i datës 16 Maj 2022 lidhur se "A mund te ofrohet maska pa kapësen e ajërit pasi qe këtë pike e plotëson vetëm një prodhues "InterspiroAirHatch".

Medicom

Pytje për: **AGJENCIA PËR MENAGJIM EMERGJENT**

Titulli: Funizim me Aparate të Frymarrjes dhe Bombola të Ajërit
Numri i prokurimit: 21432700-22-3555-1-1-1

16 Maj 2022

1. **Cilindri i Ajërit.**
   Aparati i frymarrjes përbehet nga katër komponente themelore që duhet të ketë peshë totale të lejuar 7,7 kg, duke u bazuar në specifikimin teknik.
   A mund te ofrohet bombola me peshë 4.2 kg, meqen se komponentet tjera janë më të lehta se sa pesha maksimale e lejuar në specifikimin teknik qe në tanësi nuk e kalon peshen mbi 7.9 kg dhe nuk e kalon tolerancen mbi 2% të lejuar në DT?

2. **Maska**
   A mund te ofrohet maska pa kapesën e ajërit, pasi qe ketë pike e plotëson vetëm një prodhues "Interspiro Air Hatch"? Funksionin e kësaj kapëse mund të përmbushin edhe prodhuesit tjerë duke liruar automatin e frymarrjes.

3. **Kriteret**
   Për hirë të transparencës a mund të kerkohet nga ana e juaj qe të gjithë Operatorët Ekonomik "katallogun i pajisjeve i cili nuk përputhet me atë ne faqen zyrtare të prodhuesit" të konsiderohet si i manipuluar? Ketë kërkesë po e bejmë pikerisht nga dyshimet që kemi pas në projektin në vitin 2020 "Funizim me Aparata të Frymarrjes dhe Bombola te Ajërit" 21432700-20-4902-1-1-1.

Ne këtë mënyrë Autoriteti Kontraktues i përgjigjet qe: MASKA- ka mundësi qe te përdoren edhe sisteme te ngjashme dhe ekuivalente me te specifikuara ne DT-Aneksin ne.1. Ky sistem mundëson përdorimin e ajëritte ambientit çdo here qe përdoruesit e aktivizojnë atë. Shih foton:

Autoriteti Kontraktues ne specifikim teknik tek Dosja e tenderit - tek MASK ka pasur kërkesën si vijon:

Madhesite	Min. 3 madhësi
Maska e fytyrës duhet të jetë e pajisur me një valvul të integruar të frymëmarrjes, të kyçur në maskën e fytyrës.Valvula e frymëmarrjes nuk duhet të jetë e mundur të humbasë gjatë operacionit.Maska e fytyrës duhet të jetë e pajisur me një kapëse të ajrit të ambientit që mundëson përdorimin e ajrit të ambientit ndërsa është në pritje.	

Për këtë kërkes ne specifikim teknik ka pasur kërkes për saqarim dhe atë me pyetjen si në vijim:

MASKA – A mundet që te ofrohet maska pa kapësen e ajërit, pasi që këtë pike e ploteson vetëm një prodhuess „Interspiro Air Hatch" funksionin e këapese munden qe ta plotesojn ehde prodhues te tjer duke liruar automatin e frymarrjes

Autoriteti kontraktues konform LPP dhe pyetjes sqaruese me daten 18.05.2022 ka lëshuar përgjegjein si në vijim:

MASKA – Ka mundesi që te pordoren edhe sisteme te ngjajshem dhe ekujvalente me te specifikuara ne DT- Aneksin nr.1. Ky sistem mundeson pordorimin e ajërit te ambientit saher qe pordoruesit e aktivizojn këtë.

E që ne këtë rast te përgjegjies AK ka pranuar çdo Mask që e ka sistemin e ngjajshëm për pordorim te ajërit nga ambienti pa pasur nevoj qe ta aktivizoj aparatin e frymarrjes. Autoriteti kontraktues ne sqarimet e **dates 18.05.2022** ka sqaruar edhe për peshën e **Cilindrit**, por Autoriteti kontraktues as njëher nuk ka pasur pyetje apo kerkesa për sqarime nga ana e OE-ve, lidhur me **Sistemi i lidhjes me aparatet e frymëmarrjes – P.** Dhe bazuar ne këtë pretendimi juaj se AK ka jepur sqarime per **Sistemi i lidhjes me aparatet e frymëmarrjes – P , <u>nuk qëndron</u>** ***(shih sqarimin e publikuar nga AK me daten 18.05.2022)***

Lidhur me pretendimet se OE i rekomanduar nuk plotëson kriteret e specifikimit teknik ju sqarojm se janë te pa qëndrueshme dhe te pa argumentuara ligjërit dhe profesionalisht nga ana juaj.Po ashtu për sqarimin tuaj dhe të gjith te ineresuarve po ju shpalos katalogut për Maskën te ofruar nga ana e OE te rekomanduar që dëshmon se Maska ka **Sistemin e lidhjes me aparatin e frymarrjes - „P"** si dhe Fotot e mostres e cila dëshmon për **Sistemin e lidhjes me aparatin e frymarrjes – P.**

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit të jashtëm shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi sqaron, se:

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 10.01.2023, me praninë e palëve në procedurë ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimit mbi vendimin e AK dhe vendimet tjera, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Pas analizës se procedurës për këtë aktivitet te prokurimit, Paneli Shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues, ka aprovuar kërkesat për sqarime shtese nga OE Operatoret Ekonomik te

ndryshme, te publikuar ne platformën elektronike E-prokurimi me date 18.05.2022 dhe ka larguar apo ka mundësuar duke larguar disa kritere vetëm e vetëm qe te mundësonte Operatoret Ekonomik te ofertonin me sa me shume prodhues te ndryshëm, duke dhënë mundësin te "*ngjashëm dhe ekuivalente*" ne mënyrë qe te inkurajoj qe te gjithë OE te interesuar te dorëzojnë ofertat e tyre duke siguruar qe ofertat e tyre do te vlerësohen dhe se vlerësimit do te behet ne përputhje me te gjitha dispozitat e LPP-së. PSH mori në konsideratë deklarimet e përfaqësuesit të AK i cili citon "se sqarime shtese nga OE Operatoret Ekonomik te ndryshme, te publikuar ne platformën elektronike E-prokurimi me date 18.05.2022", sa i përket maskës kanë pasur të bëjnë vetëm me kapësen e ajrit dhe jo me konektorin. Dhe OE ankues po ashtu edhe ekspertët shqyrtues gabimisht ju qasen këtij sqarimi.

Mbi bazën e gjithë dokumentacionit dhe pohimeve në seancë PSH konsideron se ekspertët shqyrtues këtë lëndë në të dyja rastet e shqyrtimit të kësaj lënde nuk e kanë trajtuar konform pretendimeve dhe arsyetimeve mbi të cilat është eliminuar OE ankues.

Për këtë PSH nuk mund ta merr si çështje e gjykuar për faktin se nuk është ndalur të çështja e konektorit por vetëm tek shtresat e izolimit të dyfishtë të maskës, ashtu siç ka qenë e sqaruar me ekspertizën 408/22.

Në katalogun e ofruar nga OE ankues figuron se sistemi i lidhjes me aparatet e frymarrjes janë me konektorin "P", ndërsa më poshtë po në atë katalog figuron se ky konektor është M16. Andaj, PSH erdhi në këtë përfundim edhe pas hulumtimeve të bëra në internet dhe në ueb faqet e maskave që janë ofruara në bazë të katalogëve se oferta e OE ankues nuk është konform Aneksit 1 të Dosjes së Tenderit e cila nuk e plotëson kushtin që maska me qenë me konektor "P".

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 dhe 60 të LPP. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet janë konform akteve ligjore të AK, dhe pohimet ankimore në ketë rast nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehen sërish në ri-vlerësim sepse, në të kundërtën kjo do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP.

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- AME

1x1 OE ankues

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.